



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 75

Datë: 05. 11. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Florian Dushi, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
2. **Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kryetar Komune në Klllokot, të mbajtura më 17 tetor 2021.**
3. **Këshillat e KQZ-së:**
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së ekipeve mobile për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, që do të mbahen më 14 nëntor 2021.
4. **Të ndryshme.**

1. Hyrje z. Kreshnik Radoniqi Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kreshnik Radoniqi : E hapim mbledhjen e 75-të të KQZ-së , me rend të ditës kemi certifikimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve lokale për kryetar komune në Klllokot , kemi këshillat e KQZ-së , KOZ me një kërkesë për miratim dhe të ndryshme, dhe a ka dikush diçka për të shtuar në rendin e ditës ?

Sami Kurteshi, pyeti rreth organizimit të ekipeve mobile për personat me aftësi të kufizuar që, duhet të jenë të angazhuar në votim, ndërsa Arianit Elshani tha se është edhe një rekomandim tjetër nga KOZ që të vendoset si pikë e rendit të ditës për shkak të shqyrtimit të një raporti nga QNR të cilin, dhe se është si rekomandim për zëvendësimin e anëtarëve të këshillave të vendvotimeve ku janë evidentuar ndryshime në numrin e votave pas rinumërimit, propozoi që të vendoset si pikë e rendit të ditës.

Në ndërkohë, me tetë vota për, u miratua rend të ditës ?

2.Certifikimi i Rezultateve Përfundimtare të zgjedhjeve lokale për Kryetar

Komune në Klllokot, të mbajtura më 17 tetor 2021

Kreshnik Radoniqi: Ne, sot e kemi pranuar vendimin prej Gjykatës Supreme të cilin e ka refuzuar ankesën, dhe se ka marrë fund procesi ankimor për komunën e Klllokotit. Atëherë, për kryetar komune në Klllokot në raundin e dytë, do të shkojnë kandidatët Vladan Bogdanovic nga Srpska Lista me 41.01 % dhe Srtajina Spasic nga subjekti Srpska Narodna Sloga me 36.33 %. Kush është për certifikimin e këtij rezultati ?

Me 8 vota për certifikohet rezultati për kryetar komune në Klllokot.

3.Këshillat e KQZ-së:

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i përbërjes së ekipeve mobile për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, që do të mbahen më 14 nëntor 2021:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar kërkesën dhe rekomandimin e sekretariatit për përbërjen e ekipeve mobile për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave që do të mbahen me 14 nëntor 2021 , pas diskutimeve të zhvilluara me shumicë votash është aprovuar ky rekomandim i sekretariatit. Besoj se para vetes e keni një tabelë ku në raport me të aprovuarën e mëparshme atë që ka qenë gjatë raundit të parë të zgjedhjeve është numër dukshëm më i vogël i ekipeve mobile të angazhuara pra dallimi nga raundi i parë në këto komuna është për FPNV-të i keni 80 ekipe mobile është 90 më pak se në raundin e parë , në ekipet mobile të covid 19 janë 57 ekipe; në total është 85 ekipeve më pak se sa në raundin e parë në këto komuna që kemi paraparë meqenëse zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve, kjo duke shkuar edhe në përshtatshmëri në krahasim me rastet që i kemi deri me datën 1 nëntor të raportuara dhe konsiderojmë që ky rekomandim të miratohet edhe nga KQZ-ja që ti mundësohet secilit qytetar pra që edhe në shtëpitë e tyre ata që janë më nevojta të veçanta dhe, ata të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë për shkak të infektimit me covid 19 tu mundësohet votimi përmes këtyre ekipeve mobile. Në disa komuna ku nuk zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve bëhet fjalë për Mitrovicën e Jugut, Lipjanit, Novobërdës, Pejë, Skënderajit, Suharekës, Ferizajit dhe Mitrovicës së Veriut do të ofrohen votimet përmes ekipeve mobile për shkak të institucioneve që kanë ata qofshin ato institucione shëndetësore qofshin ato të burgjeve që i kemi në disa pra shërbime korrektuese pra këtë rekomandim konsiderojmë që duhet të aprovohet edhe nga KQZ-ja. Ne kemi pasur diskutime dhe mendime të ndryshme në raport me këtë rekomandim të ardhur që të bëhet edhe një analizë e gjitha votave të raundit të parë të cilët kanë votuar përmes ekipeve mobile të covid 19 mirëpo edhe për shkak të kohës që merr që të trajtohet kjo çështje nga QNR që të evidentohet saktë edhe listat e nënshkrimeve të raportuara nga KQZ-ja konsiderojmë që ta aprovojmë sa më parë .

Sami Kurteshi: Ndoshta është ndonjë gabim në llogaritje, sidoqoftë unë e kam te ekipet mobile, te personat me nevojta të veçanta sepse, a ka ndryshuar gjendja e tyre shëndetësore...? Ata janë të palëvizshëm dhe natyrisht që kërkojnë me e realizua të drejtën e tyre. Tash si duket ajo ? Unë mendoj se lista e votuesve që e bën KQZ, nuk guxon me qenë listë statike sepse ndryshimet janë në shoqëri edhe bëhen përditë; nuk duhet me bë ndryshime të mëdha, e kuptoj te regjistrimi i votuesve nga jashtë që duhet një përpunim i madh është rasti me disa mijëra, mandej janë disa probleme - jo dërgimi - jo marrja por te personat që kanë nevojta të veçanta që ndryshon për çdo ditë gjendja, të dihet si ndryshon dhe numri i atyre që janë të infektuar me covid etj. Sido qoftë, mendoj se ajo listë të përditësohet nga KQZ – ja dhe ne nuk duhet të bëhemi dogmatikë në atë mënyrë ne e kemi listën...

Alim Rama: Në Këshillin për Operacione Zgjedhore, rekomandimi është votuar vetëm me dy vota që unë mendoj se është proceduralisht gabim, por pavarësisht (nuk dëgjohet).....arsyeja ka

qenë që kjo listë nuk është bërë e gjithë analiza; një është kjo që e paraqiti z. Kurteshi...! Nuk kemi analiza si janë shfrytëzuar dhe ku janë shfrytëzuar dhe në anën tjetër, një arsye tjetër është se unë nuk mundem me mbështet se mendoj që në përpunimin e këtyre të dhënave është se, në komunat ku nuk ka raund të dytë, shërbimet nuk duhet të bëhen prej KKZ-së që nuk marrin pjesë, domethënë në këtë rast Mitrovica e Jugut, Peja, Skenderaj, Suhareka, Ferizaj, Mitrovicë e Veriut. Shërbimi është dashur të jetë prej një komune që është në operacion zgjedhor; mendoj që nuk është e arsyeshme: jemi duke folur për institucione shtetërore nuk jemi duke folur për qytetarët e asaj komune...

Cemajl Kurtis: Mendoj që, në lidhje me diskutimin e kolegëve të mi, organizatat joqeveritare mund të kryejnë një pjesë të mirë të punës në bashkëpunim me KQZ-në, për shembull siç është vepruar në Prizren që ka një bashkëpunim. Dhe, kjo mendoj që ka dhënë rezultat. Shumë organizata që merren me këto probleme të personave të hendikepuar, ne mund ti kemi dhe besoj se duhet tu kushtojmë më shumë rëndësi, dhe se personat me të drejtë vote si kanë votuar deri tani, të votojnë edhe në raundin e dytë. Edhe këtu, apeloj te këto organizata që të veprojnë, sepse ka persona që mbeten jashtë procesit të votimit...Ato organizata, mund të japin shumë kontribute...

Arianit Elshani: Sigurisht pajtohem me kërkesën që vërtetë listat votuese të gjithë atyre personave me nevoja të veçanta dhe ata që janë të hospitalizuar të përditësohen deri në dy ditë para zgjedhjeve ashtu siç ka ndodhur edhe në raundin e parë kjo nevoja të veçanta ka afate kohore gjë të cilën e diskutojmë pastaj edhe te të ndryshme mirëpo inkurajojmë të gjitha organizatat që ti dërgojnë listat e atyre personave që ata i kanë të regjistruar që duhet tu mundësohet votimi nga shtëpitë e tyre. E thashë edhe më parë që ne me të vërtetë kemi pasur diskutim në raport me këto komuna që u theksuan nga z. Rama lidhur me përbërjen e tyre unë nuk besoj që përbën problem për ato KKZ duke e ditur mandatin që kanë edhe pas certifikimit të rezultateve për kuvende komunale dhe kryetar të komunave nuk besoj që e kanë problem. Nga tre punonjës të cilët do të angazhohen si komisioneve, në këtë rast për tu mundësuar votimin dhe tjetra është që ata njerëz që realisht banojnë në Mitrovicën e Jugut e njohin më mirë e dinë vendin ku është spitali dhe sa i përket Novobërdës, Gjilanit dhe ndryshe është të dërgohen nga një komunë tjetër te një komunë duhet të llogarisim edhe rrugën që e marrin ata nga një qytet në tjetrin prandaj konsideroj që ato KKZ aktuale të organizojnë ato komuna ku janë ato institucione shëndetësore dhe korrektuese prandaj rekomandoj që të aprovohet....

Florian Dushi: Prita që kryesuesi i këshillit do të flet edhe rreth aspekteve të votimit se, kolegu Rama e ngriti që nuk ka qenë e drejtë proceduralisht mënyra si ne kemi votuar në KOZ prandaj, për hir të korrektësisë në Këshill kanë marrë pjesë 3 anëtarë të Këshillit dhe 2 kanë votuar për këtë listë. Kjo, është e vërteta e gjithë asaj kjo është shumica këta janë numrat, por çështja tjetër me plot mirëkuptim për kërkesën që eventualisht të krijojmë mundësi për personat me nevoja të veçanta që të regjistrohen; Por ta keni parasysh një fakt: edhe unë jam që sidomos në raste të tilla sensitive të mos jemi plotësisht dogmatikë po që rregullat zgjedhore te ne këtë çështje e ka parandaluar në njëfarë forme për ta zhvilluar në raundin e dytë. Dhe në rregull jemi, mund të vazhdojmë me këtë proces. Sa më përket mua, thash, meqë bëhet fjalë për këtë kategori, unë jam në favor tek e fundit edhe shkeljes së rregullës sonë që është akt i yni i brendshëm dhe mund ta ndryshojmë. Vendimi ynë këtu, mund të konsiderohet se me të njëjtën shumicë ne e ndryshojmë edhe rregullën por që kam një dilemë. Këtu u përmend që organizatat të dërgojnë lista dhe kjo mendoj që është në kundërshtim edhe me natyrën e zgjedhjeve sepse, nëse këto organizata i dërgojnë listat te ne, ose ne, dhe ekipet tona shkojnë në derë të këtyre njerëzve me kuti të votimit, kjo nuk më duket korrekte prandaj, kjo duhet me qenë personale individuale; kërkesë e këtyre personave për tu regjistruar dhe për të votuar. Nuk mund të marrim ne lista dhe tu shkojmë nëpër dyer njerëzve me kuti të votimit pavarësisht, nëse ata dëshirojnë me votu ose jo. Në anën tjetër, do të mund të na ndihmonin këto lista për të ardhmen me pas parasysh edhe sa i përket organizimin edhe numrit edhe shifrave por që, unë mendoj se kjo duhet të jetë vullnetare...

Sami Kurteshi: Shikoni mirë listat, Hani i Elezit nuk është askund....!

Arianit Elshani: Ato që kanë përfunduar në raund të parë, nuk janë të përfshira këtu; ato janë larguar prej listës, vetëm ato që do të zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve janë të listuara...

Sami Kurteshi: Sidoqoftë, unë mendoj sa i përket asaj rregullores që i përmendi kolegu, i kemi disa rregullore megjithatë, rregulloret tona tash nuk kemi të bëjmë me kod të mbyllur dogmatik ose intelektual; problemi është se këto rregulla janë pak si të ngurta që s'munden me u ndryshua; nuk po them me mijëra raste se është e pamundur me i përpunuar në të gjithë Kosovën; nuk besoj që ngjajnë 10 raste, dhe ato kemi mundësi me i përditësua sa u përket këtyre personave me nevoja të veçanta, dhe këtyre që janë me covid...

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Arianit Elshani, Sami Kurteshi dhe Besnik Buzhala (SKQZ),

Në fund, me tetë (8) vota për, u miratua rekomandimi për përbërjen e ekipeve mobile për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave.

Florian Dushi: Kishte një propozime të kolegut Kurteshi, pra kishte mirëkuptim dhe pajtim të shumicës së anëtareve të KQZ-së që të lejohet regjistrim i ri apo periudha shtese për të u regjistruar përsëri personat më nevoja të veçanta; por unë konsideroj që neve na duhet vendim i komisionit qendror të zgjedhjeve dhe ketë kuadër, bashkë me vendimin do të na duhej edhe një këshill profesionale i sekretariatit për kohëzgjatjen...Pra sa dite do të kemi mundësi më lënë, sepse tani jemi shumë afër rëndit të dyte dhe nuk mund të zgjedhim shumë...

Kreshnik Radoniqi: Sa po më kujtohet mua, lista votuese është ajo që është konfirmuar para zgjedhjeve dhe shfrytëzohet edhe për rëndin e dytë!

Alim Rama: Unë mendoj që lista është e njëjtë, vetëm jemi duke folur për shërbime tani në rëndin e pare kemi diskutuar; ne nuk mund ti parashikojmë sëmundjet me covid për shembull; ne i kemi lejuar të gjithë ata të regjistrohen deri të enjten e fundit para zgjedhjeve kështu që, ne marrim tani një vendim që sekretariati mendon se mund t'i përpunoje të dhënat deri të enjten, ose të caktohet një ditë që ky proces që përfundon sot të vazhdon deri një dite të caktuar...

Kreshnik Radoniqi: Sa i përket listës votuese ju po thoni që ajo nuk preket, tani shërbimi edhe prej herës së kaluar mbet që secili prej këtyre personave që dëshiron me votuar por, nuk ka mundësi me u paraqit ka me e kontaktuar KQZ-ën...?

Alim Rama: Ne, po kërkojmë që ky afat që përfundon sot të shtyhet deri të mërkurën ose të enjten, varësisht prej mundësive të sekretariatit më i përpune të dhënat që i prodhon...

Kreshnik Radoniqi: A pajtoheni që deri më datën 9 të shtyhet regjistrimi i personave më nevoja të veçanta? A jeni për ?

Me 8 vota për. miratohet ky propozim.

Tani, vazhdojmë më piken e radhës të KOZ-it, rekomandimi për zëvendësimin e anëtareve të komisioneve të vendvotimeve.

Shqyrtimi dhe rekomandimi për zëvendësimin e anëtareve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV)

Arianit Elshani: KOZ-ë ka shqyrtuar një raport të QNR-së lidhur më ndryshimin që ka ndodhur nga numërimi në vendvotime dhe nga numërimi në QNR-ë dhe nga ato 291 vendvotime që është marr vendim

nga KQZ-ë që të rinumërohen pra është konstatuar ashtu siç e kemi parë edhe në imellat tona që ka pasur lëvizshmëri të votës në mes të kandidateve për asamble komunale dhe në mes të subjekteve politike dhe duke e ditur rendësin që ka secila vote e qytetarit që ajo të paraqitet sakte dhe drejt në formularët e rezultateve të kandidateve pra ne edhe më parë si KQZ-ë kemi kërkuar që ato këshilla të vendotimeve pra komisionet dhe kryesuesit të cilët kane qene të pa vëmendshëm në ditën e zgjedhjeve apo që kane qene pjese e skenave të organizuara qofshin ato të subjekteve politike qofshin të kandidateve për këshilltarë komunal të mos jene të angazhuar në rundin e dyte të zgjedhjeve për shkak që e para e dëmtojnë vete KQZ-ën e devijojnë dhe manipulojnë votën e qytetarit por edhe tjetra nxirin kryetare apo këshilltar komunal jo legjitim dhe duke dashur që të sanksionojmë këta këshilla të vendotimit këta komisionar dhe kryesues kemi vendosur si KOZ-ë që të i rekomandojmë sot KQZ-së zëvendësimin e këtyre këshillave të vendotimit nga subjektet politike në ato vendvotime ku ndryshimi i numrit të votave për subjektet politike është më shumë së një vote dhe për këshilltarët komunal është më shumë së 3 vota. Ne kemi parë edhe nga QNR-ë edhe nga ato rezultate që kemi marr në ditën e zgjedhjeve nga KKZ-të së vetëm një vote ka ndikuar cofte që një subjekt politikë të marr një këshilltar më shumë në komune cofte që një kandidate të kaloje një kandidate tjetër në listën hyrës në kuvendin komunal. Prandaj konsiderojmë që gjithë këta komisionar të këtyre komunave në rundin e dyte të zëvendësohen dhe ata të cilët kane qene të angazhuar në komunat ku tash ka përfunduar procesi zgjedhor në rundin e parë ato lista e para të i dërgohen subjekteve politike pra të njoftohen edhe subjektet politike që ata persona nuk kane paraqitur sakte vullnetin e qytetareve. Dhe një here edhe KQZ-ë ketë liste të këtyre të angazhuarve do ta mbaj dhe do të ketë në konsiderata edhe për zgjedhjet e ardhshme kurdo që mbahen, në qofte se ju nevojitet si statistika për këto 18 komuna nga 21 të cilat do të hyjnë në balotazh pra në Gjakovë 14 vendvotime 14 klase do të kërkohet ndërrimi në tersi, Në Drenas 8 klase, Gjilan 11 klase 11 këshilla të vendotimeve, Istog 2 këshilla te vendvotimeve, në Kaçanik 5 këshilla te vendvotimeve në Kline 3, Fushë Kosovë 5, Kamenica 2, Obiliq 1, Rahovec 7 vendvotime do të kërkohet zëvendësimi i tyre, Podujeve më 17 vendvotime, Prishtina më 29 vendvotime që do të ju kërkohet zëvendësimi i gjithë përbërjes, Prizren 20, Shtime 4, Viti 6, Vushtrri 8 , Malisheva 7, dhe Mamushe 1. Në baze të një raporti të cilin kemi kërkuar ne edhe të plotësohet përmbajtësish më disa të dhëna të tjera pra kemi parë që ndryshimi i votave brenda asamblistëve brenda kandidateve për këshilltar komunal në Prishtine ka ndodhur në 1868 vota më atë së çka ka evidentuar KQZ-ë në Ferizaj më 977, dhe Gjakove 675. Ketë raport të plotësuar të përditësuar më ato kërkesa tona të KOZ-ë do ta kemi para vetes në mbledhjen e ardhshme sepse ka nevojë për disa të dhëna shtese prandaj kërkoj që ky rekomandim për zëvendësimin e anëtareve të këshillat e vendotimit

të miratohet më qene së ka qene vullnet i gjithë neve si anëtare që nga shpallja e zgjedhjeve që vullneti i qytetareve të shprehet qartazi.

Sami Kurteshi: Unë e lexova më kujdes, e pash më kujdes tani po hy menjëherë në teme këtu janë për 291 vendvotime të cilat janë rinumëruar në këtë rundin e fundit ku bëjnë pjese disa vendvotime 30,40 apo 50 s'di për çfarë arsyeje edhe ishin ato tjera d.m.th që kane dal më mangësi nga verifikimi qe kemi bere apo auditimi krejt i rastësishëm . Unë tani po i hap disa çështje, 1 ne kemi kërkuar që çdo vendvotime që përcillet më pa rregullsi pranohet në KQZ-ë duhet të evitohet tregohen shkaqet edhe ata komisionar që kane përcill një fletëvotime një votime të tille më mangësi të tilla mos më qene ma komisioner ne e kemi bere këtë ftese si KQZ-ë qysh në fillime edhe më gjithë atë ata nuk e kane marr seriozisht sepse janë duke menduar se hajt se do të shkoj qysh ka shkuar më herët, Unë jam për veprime ligjore por pa asnjë lëshime kjo është çështja e pare të gjitha kutia që janë rinumëruar ku janë konstatuar më procesverbale mangësi, ata komisionarë të atyre vendvotimeve nuk duhet të angazhohen, ja dërgoni partive politike këta njerëz nuk duam më pa këtu se nuk i marrim, atu e keni mbështetjen edhe tonën, e dyta megjithatë ne kemi edhe diçka tjetër që nuk regjistrohet, unë po e përcill Hanin e Elezit në Hane të Elezit kandidati vet e ka pranuar vet e ka pranuar i PDK-ës ka thane po unë kam qene në të gjitha vendvotimet edhe i kam vizituar, PZAP-ë e ka konstatuar si shkelje ketë dhe e ka dënuar më 10 mije euro, gjykata supreme e ka pranuar ketë shkelje në anën tjetër kemi komisionar të 11 vendvotimeve edhe KKZ-ën tone as një vrenjte në libra e votimeve nuk është se kandidati e ka shkel rregullën zgjedhore asnjë vrenjte ne duhet më menduar për at KKZ-ën që kemi në Hane të Elezit, duhet më menduar për komisionarët e gjitha vendvotimeve, kandidati e ka pranuar botërisht po unë kam qene ajo është e ndaluar për at e ka dënuar PZAP-ja më 10 mije euro at vendim e ka verifikuar vërtetuar gjykata supreme, Prandaj unë propozoj nese doni ketë mbledhje ose mbledhje tjera që këta njerëz mos më qene më pjese e KQZ-së ai mundet më pasur lojalitet politike edhe preferenca politike partiake, shumë mire edhe mendoj që është shumë mire që kane por ai nuk ka lojalitet institucional edhe ne ditën e zgjedhjeve krejt komisionarët që kemi të partive politike duhet më ju thane ju jeni anëtar të partive politike edhe keni lojalitetin e juaj partiak deri ditën e zgjedhjeve ditën e zgjedhjeve jeni anëtar të KQZ-së, paguheni nga KQZ-ë dhe keni obligime ligjore lojalitetin ndaj institucionit dhe ndaj shtetit edhe ata siç, duket ketë dallim nuk e banjë. Prandaj unë propozoj dhe kërkoje nga sekretariati që gjithë këto vendvotime që janë përcill më mangësi edhe kane ardhur këtu kane qite pune shtese më u evidentuar arsyet pse kane qene mangësitë më e bo listën e atyre komisioneve edhe komisionet komunale dhe më nxirr vendim që ata njerëz më nuk mund te punojnë për KQZ-ë.

Arianit Elshani: Është shumë e drejt kjo që potencoj për faktin që nuk janë vetëm 291 vendvotime që kane shkuar në rinumërim behet fjale diku rreth 340 vendvotime që kane shkuar në rinumërim dhe ata për shkaqe të ndryshme prandaj ky raport duhet të pastrohet në tersi dhe për këtë arsye nuk është ndare tek të gjithë e kemi trajtuar në KOZ-ë që të përditësohet më të gjitha këto të dhëna, kategorizohet për secilin probleme dhe për secilën çështje që ka shkuar realisht në rinumërim ai vendvotime dhe sa i përket Hanit të Elezit ne kemi pare edhe në libra të votimit, sepse komisionarët janë nga gjitha subjektet politike nuk është konstatuar ndonjë pa rregullsi por ka marr këtë vendim edhe PZAP-ë edhe gjykata supreme dhe prandaj nuk do dëshiroja të lëshohem në diskutim për at teme por është një mesazh i qarte që po dëshirojmë të dërgojmë të gjithë komisionarët pavarësisht subjekteve politikë që pa rregullsitë pa vëmendshme ia e tyre që thash edhe një here por qofshin ato edhe s’kemi të organizuara nga kandidatet apo nga subjektet politike nuk do të tolerohen nga ne si anëtar të KQZ-së dhe do të marrim një sanksione që realisht e kemi mundësin të bëjmë e pastaj janë organet e hetueses dhe prokurorisë që do të merren më ato të cilat kane ndikuar pra edhe në numrin e përgjithshme të kutive që janë rinumëruar por edhe të pa rregullsive në raport të votave për këshilltar komunal dhe atyre për subjekte politikë.

Alim Rama: Ne, të gjithë këtu jemi pajtuar të rrisim kujdesin në vendvotime të gjithë unanimisht e kemi pranuar këtë liste por kjo liste nuk mënojnë që duhet më qene përfundimtare në rast të hetimeve të dhënave pasi të gjitha të dhënat nuk janë përpunuar kështu që kësaj liste mundet me i shtuar edhe disa vendvotime ne nuk kemi marr për baze dhe nuk kemi siguruar që kemi marr për baze lista të rinumërimeve që kane ndodhe për kryetare komune sepse raporti ka qene vetëm për kuvende komunale po si do që të jete kjo do të jete lista baze për shkaqe të përgatitjeve po mendoj që duhet mu aprovuar sot. Tani për tani ndryshohet 151 këshillat e vendvotimit që kane marr pjese në zgjedhje e 17 tetorit.

Florian Dushi: Ashtu siç u tha ne sot e kemi shqyrtuar në KOZ-ë të gjitha ndryshimet që na janë prezantuar dhe që i ka prodhuar rinumërimi kemi shqyrtuar disa here edhe nivelin e tolerancës po e quaj kështu edhe pse ne nuk duhet më qene tolerant fare mandej për asnjë vote të vetme por megjithatë nuk do të duhet që të kalojmë as në rundin e dyte më këto përbërje të këtyre këshillave të cilat kane shkaktuar rinumërim dhe kane bere që rezultatet në vendvotime të caktuara qofshin për subjektet politike ose për kandidatet të jene të pa sakta prandaj unë pajtohem që këtë faze për shkak që edhe mos më vështirosu operacionin e emërimeve dhe trajnimin e këshillave për rundin e dyte të mbesim më kaq por megjithatë në të ardhmen nivelin e tolerancës sa i përket mos emërimit të këtyre këshillave nga ana e KQZ-së do të duhej më qene zero. Për faktin se ashtu qysh kemi pasur mundësi të shohim veçanërisht tek kandidatet për asamble ka raste kur për një vote dikush behet ose nuk behet asamblist. Dhe në këto zgjedhje lokale kjo është shumë

e shprehur në mjaft komuna prandaj këtë fazë në mund të shkojmë më këtë nivel të tolerancës por insistojë dhe kërkojë nga ju mbështetje që sekretariati pas këtyre zgjedhjeve thjesht të na ofrojë informacione për gjitha rastet ku ka pasur ndryshim të rezultatit të zgjedhjeve është një votë në pyetje a janë tre ajo është rezultat i pa sekte i zgjedhjeve prandaj të na jap informacione dhe thjeshte ashtu qysh u përmend edhe nga disa kolege mandej të njoftohen edhe subjektet politike që të nominalit të juaj këto zgjedhje për shkak së e kanë shkaktuar rinumërimin nuk mund të jeni edhe më tutje ose nuk mund të shërben asnjëherë më si anëtarë ose kryesues të këshillave të vendotimeve pse jo përfundimisht në KQZ-ë të kemi një listë të zeze që do të quajmë në thonjëza të njerëzve që kanë qene jo korrekt të pa përgjegjshëm në proceset e më hershme zgjedhore dhe asnjëherë më mos të jeni pjesë e asnjë trupe zgjedhore brenda KQZ-së.

Sami Kurteshi: Ne, nganjëherë bëjmë lëshime, herën e kaluar kemi pasur toleranca plus minus vota edhe ne kemi disa rregulla që janë kotuar që janë kundër kushtetues, pse është kundër kushtetues, parimi kushtetues thotë vota është personale e lire e pa prekshme edhe e pa tjetërsueshme, edhe ne bëjmë tolerance tri vota që kushtetua thotë vota është personale, një votë është e rëndësishme, s' kemi në drejt asnjë votë më tjetërsuar, as me prek as me lejuar mos me qene personalë. Këtu e kam problemin edhe më rregullore tona ne për lehtësim të punës po e bëjmë tolerancën plus minus 3. Mire njerëzve nuk po ju bijën mend më dërguar gjykate kushtetues ajo thotë nuk ke drejt më bo asnjë tolerance. Unë mendoj që ne këtu mundemi më treguar nivel mundemi më vendos norma më thirr përgjegjësi veten edhe ata, por nuk duhet më lejuar që Kosove jo vetëm për një hatër më na shkuar 2 a 3 vota s'ka problem po na ngjanë pastaj unë po behëm i sinqerta që njerëzit thirrën këqyrë bre për një votë s' po mundem më hy kuvend a mundeni më bo diçka, ky është fjalori të cilin flasim, unë s'po them që më kanë thirr të PDK-së apo LDK-së të VV-së sepse kjo është krijuar në kokat e njerëzve që me vota tona mundemi më luajt ne, ky është problemi, dhe për mos më lejuar këtë ne duhet më ju përmbajt kushtetues asgjë tjetër...

Kreshnik Radoniq: Nëse s'ka dikush diçka tjetër e qes në votim rekomandimin për zëvendësim të anëtareve të këshillave të vendotimeve. Kush është për?

Me 8 vota për, miratohet rekomandimi për zëvendësimin e anëtareve të këshillave të vendotimeve ku janë evidentuar ndryshme për numrin e votave pas rinumërimin.

4. Të ndryshme!